



Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik në pajtim me nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik nxjerrë këtë:

Udhëzim Administrativ Nr. 01/2015

Për **prioritetin** e ofertuesve vendor (neni 60A i Ligjit Nr. 04/L-237 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik)

Neni 1 Qëllimi

- 1.1. Qëllimi i dispozitës është që të sigurojë një trajtim preferencial për ofertuesit vendor në mënyrë që ndërmarrjeve të Kosovës t'iu lehtësohet qasja në tregun publik dhe si rrjedhojë të zhvillohet ekonomia vendore.
- 1.2. Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha procedurat e tenderimit për shërbime, mallra dhe punë pa marrë parasysh vlerën e kontratës me kusht që tenderët të jenë dorëzuar nga ofertuesit vendor dhe ofertuesit e huaj. Në të kundërtën, nëse në një procedurë të tenderimit dorëzohen oferta vetëm nga Operatorët Ekonomik vendor, nuk do të aplikohet trajtimi preferencial.
- 1.3. Me qëllim të zbatimit të kësaj dispozite Ofertuesit Vendor duhet të jenë operatorët ekonomik (personat fizik ose juridik) **të cilët janë Rezidentë** në përputhje me ligjin kombëtar Nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale.
- 1.4. Në përputhje me ligjin e lartpërmendur, "Rezident" do të jetë:
 - Një person fizik i cili ka vendbanim kryesor në Kosovë ose është fizikisht i pranishëm në Kosovë për njëqind e tetëdhjetë e tre (183) ditë apo më tepër në cilëndo periudhë tatimore; ose
 - Një entitet që është themeluar në Kosovë ose ka vendin e tij të menaxhimit efektiv në Kosovë.
- 1.5 Për të përfituar trajtimin preferencial të dhënë nga Neni 60A i LPP-04/L-237, ofertuesit vendor do të dëshmojnë se janë Rezident duke dorëzuar me tenderin e tyre dëshmitë e mëposhtme dokumentuese:
 - a) për personat juridik, një kopje të certifikatës së regjistrimit të biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës;

b) për personat fizik, një kopje të certifikatës së Numrit fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

1.6 Nëse tenderët dorëzohen nga Operatorët Ekonomik vendor dhe të huaj, trajtimi preferencial do të jetë i rezervuar vetëm për ata Operatorë Ekonomik që dëshmojnë të jenë Ofertues vendor duke dorëzuar me tenderët e tyre dhe dokumentet e përmendura në paragrafin 1.5. Në rast një Operator Ekonomik vendor nuk dorëzon dokumentet e mësipërme, ai nuk do të ketë të drejtën për trajtim preferencial. Për këtë qëllim, mungesa e provave të dokumentuara për pranueshmërinë e Prioritetit Vendor përcakton vetëm te drejtën për trajtimin preferencial, dhe në asnjë rast, nuk përcakton, përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedura e tenderimit.

1.7 Në rast të ofertimit të përbashkët, grupi apo konsorciumi do të kenë të drejtë për trajtim preferencial nëse të gjithë anëtarët e grupit apo konsorciumit dëshmojnë të jenë ofertues vendor në përputhje me paragrafin 1.4. Për këtë qëllim, **të gjithë anëtarët e grupit ose konsorciumit** duhet të dorëzojnë me tenderin dëshmitë dokumentare për pranueshmëri, siç përmendet në paragrafin e mësipërm 1.5. Në qoftë se një grup ose konsorcium është i përbërë nga tre subjekte dhe të gjithë ata paraqesin dokumentet e mësipërme për pranueshmëri, grupi apo konsorciumi do të ketë të drejtën për Prioritet Vendor. Në të kundërtën, atëherë kur vetëm një nga anëtarët e grupit apo konsorciumit nuk është Rezident ose nuk paraqet provat e kërkuara dokumentare për pranueshmëri, i gjithë grupi apo konsorciumi nuk do të ketë të drejtën për Prioritet vendor.

1.8 Në rast të nën-kontraktorëve, Operatorët Ekonomik do të kenë të drejtën për Prioritet Vendor nëse ofertuesi dhe nën-kontraktori dëshmojnë të jenë Resident në përputhje me paragrafin 1.4. Për këtë qëllim, **ofertuesi dhe nën-kontraktori** duhet të dorëzojnë me tenderin dëshmitë dokumentuese për pranueshmëri, siç përmendet në paragrafin e mësipërm 1.5. Nëse një ofertues në tenderin e tij deklaron se do të nënkontrakttojë një operator tjetër ekonomik, ofertuesit do të kenë të drejtë për Prioritetin Vendor vetëm atëherë kur ofertuesi dhe nën-kontraktori (edhe nëse kombëtar) paraqesin dokumentet e kërkuara për drejtën e Rezidentit. Në të kundërtën, nëse ofertuesi apo nën-kontraktuesi nuk janë rezident ose nuk paraqesin provat e kërkuara dokumentuese për të drejtën, ofertuesi duhet do të ketë të drejtën e Prioritetit Vendor.

Neni 2 Trajtimi preferencial

2.1 Nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në Nenin 1, Autoritetet kontraktuese do të zbatojnë trajtimin preferencial për ofertuesit vendor sipas kriterit për dhënie të kontratës ("tenderi ekonomikisht më i favorshëm" ose "çmim më i ulët").

2.2 Kur në dosjen e tenderit është përcaktuar kriteri i shpërblimit të kontratës "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm", Autoritetet Kontraktuese do të përcaktojnë tenderin ekonomikisht më të favorshëm sipas rregullave të mëposhtme:

- a) kur operatori ekonomik më i miri në renditjen përfundimtare është një Ofertues Vendor, Ofertuesi i sipërpërmendur Vendor gjithmonë do të jetë konkurrenti i zgjedhur.
- b) kur operatori ekonomik më i miri në renditjen përfundimtare është një Ofertues Jo-Vendor (ose ndërkombëtar), ofertuesi i sipërpërmendur Jo-vendor (ose ndërkombëtar) do të jetë konkurrenti i zgjedhur me kusht që ndryshimi në pikë në mes të ofertuesit Jo-vendor (ose ndërkombëtar) dhe ofertuesit më të mirë Vendor tejkalo 10 pikë.

Shembulli 1

Renditja	Konkurrentet	Piket	Tenderi ekonomikisht me i favorshëm
1	Ofertues Jo-vendor	100	X
2	Ofertues Vendor	85	

Shembulli 2

Renditja	Konkurrentet	Piket	Tenderi ekonomikisht me i favorshëm
1	Ofertues Jo-vendor	100	X
2	Ofertues Jo-vendor	95	
3	Ofertues Vendor	89	

- c) kur operatori ekonomik me i miri në renditjen përfundimtare është një ofertues jo-vendor (ose ndërkombëtar), Ofertuesi Vendor do të jetë konkurrenti i zgjedhur me kusht që ndryshimi në pike në mes të ofertuesit jo-vendor (ose ndërkombëtar) dhe ofertuesit Vendor nuk tejkalon (ose është i barabartë) 10 pikë.

Shembulli 1

Renditja	Konkurrentet	Piket	Tenderi ekonomikisht me i favorshëm
1	Ofertues Jo-vendor	100	
2	Ofertues Vendor	94	X

Shembulli 2

Renditja	Konkurrentet	Piket	Tenderi ekonomikisht me i favorshëm
1	Ofertues Jo-vendor	100	
2	Ofertues Jo-vendor	95	
3	Ofertues Vendor	92	X

Shembulli 3

Renditja	Konkurrentet	Piket	Tenderi ekonomikisht me i favorshëm
1	Ofertues Jo-vendor	100	
2	Ofertues Jo-vendor	95	
3	Ofertues Vendor	90	X

2.3 Kur në dosjen e tenderit është përcaktuar kriter i shpërblimit të kontratës "Çmimi më i ulët", Autoritetet Kontraktuese do të përcaktojnë tenderin më të mirë sipas rregullave të mëposhtme:

- kur çmimi më i mirë në renditjen përfundimtare është ai i ofruar nga një Ofertues Vendor, Ofertuesi i sipërpërmendur Vendor gjithmonë do të jetë konkurrenti i zgjedhur.
- kur çmimi më i ulët në renditjen përfundimtare është ai i ofruar nga një Ofertues Jo-Vendor (ose ndërkombëtar), çmimi i tillë do të zgjidhet atëherë kur çmimi më i ulët i ofruar nga Ofertuesi Vendor tejkalon 15% të çmimit të ofruar nga Ofertuesi i sipërpërmendur Jo-Vendor (ose ndërkombëtar).

Shembulli 1

Renditja	Konkurrentet	Çmimi/Euro	Çmimi me i ulet
1	Ofertues Jo-vendor	100.000	X
2	Ofertues Vendor	118.000	

Shembulli 2

Renditja	Konkurrentet	Çmimi/Euro	Çmimi me i ulet
1	Ofertues Jo-vendor	100.000	X
2	Ofertues Jo-Vendor	104.000	
3	Ofertues Vendor	116.000	

- kur çmimi me i ulet ne renditjen përfundimtare është ai i ofruar nga një Ofertues Jo-Vendor (ose ndërkombëtar), çmimi me i ulet i ofruar nga Ofertuesi Vendor do të përzgjidhet nëse ai çmim nuk tejkalon (ose është i barabartë) 15% e çmimit te ofruar nga Ofertuesi i sipërpërmendur Jo-Vendor (ose ndërkombëtar).

Shembulli 1

Renditja	Konkurrentet	Çmimi/Euro	Çmimi me i ulet
1	Ofertues Jo-vendor	100.000	
2	Ofertues Vendor	107.000	X

Shembulli 2

Renditja	Konkurrentet	Çmimi/Euro	Çmimi me i ulet
1	Ofertues Jo-vendor	100.000	
2	Ofertues Jo-Vendor	105.000	
3	Ofertues Vendor	113.000	X

Shembulli 3

Renditja	Konkurrentet	Çmimi/Euro	Çmimi me i ulet
1	Ofertues Jo-vendor	100.000	
2	Ofertues Jo-Vendor	111.000	
3	Ofertues Vendor	115.000	X


2.4 Për qëllime të këtij neni, të gjitha çmimet e ofruara nga Operatorët Ekonomik do të llogariten si përfshirëse të të gjitha tatimeve, taksave dhe tarifave doganore të zbatueshme në Kosovë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

3.1 Ky udhëzim Administrativ hynë në fuqi me datë: 10.03.2015

05/03/2015

Data e nënshkrimit


Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së